



Hidromorava
Gjilan
KOMPANIA RAJONALE
E UJËSJELLESIT
HIDROMORAVA Sh.a.
No. 1562 Data 30.10.2024
GJILAN

RE-JUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIK OF KOSOVO DEVETIJA - YUJAMA - GOVERNENT MINISTRIA E TROKUVESIT MINISTRIJA ZA EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY			
Njësiri Org. Org. Jedin Org. Unit	01/3	Nr. Prot. Br. Prot Prot.No	6382
Nr. Tërndalo Proj. shprehim No. projek	✓	Data Datum Date	31.10.24
PRISTINE A		NO.1	

KOMPANIA
RAJONALE E UJIT
HIDROMORAVA
GJILAN

PLANI I BIZNESIT

2025-2027



kru-hidromorava.com



"Planeti, ajri, toka dhe uji nuk na janë lënë trashëgimi nga paraardhësit, por i kemi huazuar nga fëmijët tanë. Prandaj, duhet t'ua lëmë atyre të paktën në gjendjen që i kemi marrë."

– Gandhi –



1. HYRJJE

Plani i Biznesit 2025-2027 përshkruan vizionin strategjik, qëllimet dhe planet e veprimit për tre vitet e ardhshme, fokusohet në përmirësimin e shërbimeve, sigurimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe përshtatjen ndaj sfidave të brendshme dhe të jashtme, përfshirë ndryshimet klimatike, rritjen e popullsisë dhe ndryshimet rregullatore.

Në zhvillimin e planit të biznesit rëndësi i kushtohet edhe ndikuesve të jashtëm: si legjislacioni ekonomik e social, struktura organizative, qeverisja dhe menaxhimi i riskut.

Objektivat e Kompanisë janë të orientuara drejt shërbimit sa më të mirë duke ndërtuar strategji dhe identifikuar indikatorët kyç për t'i arritur caqet dhe për ta përmbushur planifikimin.

Në planin e performancës të kompanisë, burimet njerëzore konsiderohen si një komponentë themelore në realizimin e objektivave të saj.

Objektivat financiarë përfshijnë uljen e kostos së ofrimit të shërbimeve duke ofruar efikasitet operacional. Plani ofron një përmbledhje të menaxhimit financiar të biznesit për

vitet financiare 2025 - 2027, duke përfshirë shitjet e ujit dhe të ardhurat e parashikuara, shpenzimet kapitale, performancën buxhetore dhe shpenzimet operative.

Në bazë të iniciativave dhe aktiviteteve aktuale, Kompania parashikon që për vitin 2025 të arrijë arkëtim nga shitja e ujit në vlerë rreth 3,055,362.00 €, shpenzimet operative të jenë rreth 2,292,414.00 € dhe investime kapitale në vlerë prej 607,200.00 €, të cilat janë të përcaktuara nga Autoriteti Rregullator për Ujëra si: përtëritje të infrastrukturës, rritje e infrastrukturës dhe mirëmbajtje kapitale jo-infrastrukturore, dhe pjesën tjetër të mjeteve në përtëritje për ujëra të ndotura.

Aktivitetet kryesore të parashikuara në planin trevjeçar të biznesit janë përshkruar më poshtë, me synimin për të siguruar që shërbimet e furnizimit me ujë të arrijnë objektivat strategjike të Kompanisë në të ardhmen.

Gjatë periudhës 2025 do të vazhdohet me ngritjen e normës së faturimit të bazuar në lexim të ujëmatësve deri në 100%, ku do të përfshihet edhe pastrimi i bazës së të dhënave për konsumatorët jo-ekzistent.

PËRMBATJA

1. HYRJE 3

1.1. Historiku i kompanisë KRU Hidromorava

1.2. Misioni i Kompanisë

1.3. Rreziqet e Kompanisë

2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË KOMPANISË 13

2.1. Projeksionet nga viti 2023, 2024 dhe parashikimi 2025

3. MASAT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE 17

3.1 Objektiva e parë- sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit

3.2 Objektiva e dytë - zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit

3.3 Objektiva e tretë - Arkëtimi i borxheve

3.4 Objektiva e katërt - rritja e shkallës së faturimit dhe arkëtitimit

4. TARIFAT E SHËRBIMIT 21

5. PLANI I MENAXHIMIT TË ASETIVE 22

6. GJENDJA AKTUALE E PERSONELIT 25

6.2 Nivelet e aftësisë dhe programet e trajnimit

6.3 Programet e rekrutimit

7. PRODHIMI I UJIT PËR VITIN 2025 31

7.1 Kualiteti i ujit të pijshëm në kuadër të Zonës së Shërbimit

8. TË ARDHURAT NGA ARKËTIMI DHE SHPENZIMET OPERATIVE 35

9. PLANI I SHËRBIMIT TË SHITJES 39

9.1 Politikat dhe programet e matjes

9.2 Evitimi i lidhjeve ilegale, lidhjeve fiktive dhe lidhjeve pasive

9.3 Përditësimi i bazës së konsumatorëve

10. PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE: 2025-2027 41

10.1. Ndërrimi (zëvendësimi) i gypave të ujësjellësit dhe ri kycjet individuale DN80 mm AC deri DN 200 mm PE (Plan Tarifor)

10.2. Investime në kycjet individuale

KomunaT Gjilan, Kamenicë

10.3. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Kllokotit

10.4. Investime në rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit në zonat rurale Gjilan, Viti

10.5. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit - Zona Urbane Gjilan

10.6. Ndërtimi i rezervuarit në Gjilan dhe Kamenicë (Proces Tarifor)

10.7. Shtimi i kapacitetit të ujit përmes hulumtimeve të burimeve ujore

10.8. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në zonat rurale Kamenicë dhe Viti

10.9. Ndërtimi i pusëve për DMA

10.10. Ndërrimi i sistemit SCADA (Moduleve, PLC dhe PC-ve) FPU Përlepnice

10.11. Zëvendësimi i gypit zona urbane Viti

10.12. Ndërtimi i kolektorëve fshatrat Përlepnice, Dobërçan, Kmetoc, Shillovë

10.13. Ndërrimi i gypit të rrjetit të ujërave fekale (Plan Tarifor)

10.14. Ndërtimi i rrethojës Stacionet e Pompimit Kamenicë

10.15. Investimi në FPU Letnicë

10.16. Investimi në Pajisje Elektro-makinere

10.17. Izolimi i objektit të administratës Viti

10.18. Investimi në renovim të zyrave (të bartura nga 2024)

10.19. Ujëmatës dhe Pllomba për ujëmatës

10.20. Blerja e pajisjeve fazonerike

10.21. Investimi në rrjetin e kanalizimit të bartura 2024

10.22. Investimi në filtra në Stacione Pompimi

10.23. Investimi në FPU (të bartura nga 2024)

10.24. Investimi në dëmet e shkaktuara nga rrufeja 2024

10.25. Sonda për matjen e parametrave fiziko - kimike

10.26. Investime në sigurimin e pajisjeve elektrike në FPU Përlepnice dhe Velekincë nga KRU Hidromorava në Gjilan, viti 2024/2025 (të bartura nga 2024)

10.27. Investime në sigurinë e burimeve të ujit në zonën e shërbimit që menaxhohen nga KRU Hidromorava në Gjilan, Viti dhe Kamenicë viti 2023/2024 (të bartura nga viti 2024)

10.28. Investime në blerjen e pajisjeve makinerike

10.29. Investimi në pajisje për detektimin e bllokimeve të rrjetit të kanalizimit (të bartura nga 2024)

10.30. Investimi në siguri dhe punë


10.31. Veturë 4x4 për divizionin për operim dhe mirëmbajtje të rrjetit të ujësjellësit si dhe divizionit për prodhim

10.32. Pajisje për detektim të humbjeve

10.33. Furnizimi me mjete (pajisje) IT (të bartura nga 2024)

10.34. Projektet e planifikuara të realizohen nga burimet e jashtme për periudhën 2025- 2026.

11. REKAPITULLIMI I PROJEKTEVE 2025-2027 NGA INVESTIMET E KRU HIDROMORAVA/ DONATORË 54



PËRMBATJA

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Treguesit e Performancës

Tabela 2 Planifikimet sipas procesit tarifor 2024 (shprehur në '000 m³ ose '000 euro)

Tabela 3 Pasqyra e të ardhurave , planifikimi 2024 /2025

Tabela 4 Performanca nëntë mujore, për vitin 2024 (shprehur në "000 m³ ose "000 euro)

Tabela 5 Planifikimi i performancës operative për vitin 2025

Tabela 6 Tarifat

Tabela 7 Gjendja aktuale e personelit

Tabela 8 Moshë e të punësuarve 20

Tabela 9 Numri i të punësuarve që do të pensionohen 2025-2027

Tabela 10 Rekrutimi i stafit të ri për vitin 2025

Tabela 11 Parashikimi i Arkëtimit 29

Tabela 12 Shpenzimet sipas kategorive për vitet 2023, 2024 dhe 2025

Tabela 13 Investime në ndërrimin e gypave të ujësjellësit dhe ri kyçjet individuale

Tabela 14 Investime në kyçjet individuale Komuna Gjilan, Kamenicë

Tabela 15 Ndërtimi i rrjetit të

ujësjellësit-Komuna e Klokotit

Tabela 16 Investime në rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit

Tabela 17 Investime në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit

Tabela 18 Investime në ndërtimin e rezervuarëve

Tabela 19 Investime në shtimin e kapaciteteve

Tabela 20 Investime në ndërtim të rrjetit

Tabela 21 Investime në ndërtim e DMA Zonave

Tabela 22 Investime në ndërtim e sistemit SCADA

Tabela 23 Investime në zëvendësim të gypave Viti

Tabela 24 Investime në ndërtimin e kolektorëve

Tabela 25 Investime në ndërrimin e gypave 36

Tabela 26 Investime në ndërtimin e rrethojës

Tabela 27 Investime në ndërrimin e Akuatorëve

Tabela 28 Investime në Pajisje Elektro-makinerie

Tabela 29 Investime në objekt

Tabela 30 Investime në renovime të zyrave dhe arkave

Tabela 31 Investime në blerje të ujëmatësve

Tabela 32 Investime në blerjen e pajisjeve fazonerike

Tabela 33 Investime në rrjetin e kanalizi mit

Tabela 34 Investime në filtra të Stacioneve të Pompimit

Tabela 35 Investime në FPU

Tabela 36 Investime në dëmet e shkaktuara nga rrufeja

Tabela 37 Investime në Sonda për matjen e parametrave fiziko-kimike

Tabela 38 Investime në sigurimin e pajisjeve elektrike

Tabela 39 Investime në sigurimin e burimeve të ujit - ndërtimi i shtëpizave dhe rrethojave për sigurinë burimeve ujore

Tabela 40 Investime në blerjen e pajisjeve makinerike

Tabela 41 Investime në pajisje për detektim të bllokimeve të rrjetit të kanalizimit

Tabela 42 Investime në siguri dhe mjete punë

Tabela 43 Investime në blerjen e veturave 4x4

Tabela 44 Investime në pajisje për detektim të humbjeve të ujit

Tabela 45 Investime IT

Tabela 46 Situacioni i propozuar për ndërrimin e gypit prej burimit Guri i Hoxhës deri në FPU ne Përlepnice

Tabela 47 Rekapitullimi i investimeve vetanake 2025

Tabela 48 Rekapitullimi i investimeve vetanake 2025-2027

Tabela 49 Rekapitullimi i investimeve nga

donatorët 2025-2027

Tabela 49 Rekapitullimi i investimeve sipas kategorive 2025-2027

Tabela 51 Rekapitullimi i projekteve 2025-2027

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 Organogrami

Figura 2 Skema e furnizimit me ujë Gjilan

LISTA E HARTAVE

Harta 1 Zona e shërbimit 8

Harta 2 Vlerësimi i Aseteve Nëntokësore


Harta 3 Ndërrimi i gypit transportues nga burimi Guri i Hoxhës deri të FPU Përlepnice

LISTA E GRAFIKËVE

Grafikoni 1 Moshja e të punësuarëve


Grafikoni 2 Prodhimi i Ujit për vitin 2025

Grafikoni 3 Shpenzimet sipas viteve



SHKURTESAT

AKM	Agjencia Kosovare e Metrologjisë
ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
BRrA	Baza Rregullatore e Aseteve
PMA	Plani i Menaxhimit të Aseteve
NSH	Niveli i shërbimit
KRU	Kompania Rajonale e Ujësllësit
UPF	Uji i pa Faturuar
O&M	Operimi dhe Mirëmbajtja
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
UM	Ujëmatës
DMA	District Metered Area



**ZONA E SHËRBIMIT
KRU "HIDROMORAVA"**

Legjenda


- Komunal
- Zona e shërbimit
- Me Ujësjellës
- Pa Ujësjellës


Komuna	Nr. Vendbanime
Gjilan	13
Kamenicë	8
Viti	11
Novobërdë	5
Ranilugë	6
Partesh	1

Departamenti për planifikim urbanistik dhe menaxhimin e infrastrukturës ZIRK & OSK s.r.l.

Data: 23/10/2023

Zona e Shërbimit





Zona e shërbimit

1.1. Historiku i KRU Hidromorava

Furnizimi me ujë të pijshëm i qytetit të Gjilanit nga ujësjellësi publik filloi rreth vitit 1940, kur u ndërtua kaptazhi i parë pranë fshatit Koretishtë, i cili ndodhet rreth 4 km larg qendrës aktuale të Gjilanit. Me kalimin e kohës, sistemi vazhdimisht është rehabilituar, zgjeruar dhe modernizuar për t'iu përshtatur nevojave në rritje të qytetit.

Në vitin 1971, është filluar një projekt për zgjerimin e kapaciteteve të ujit të pijshëm për Gjilanin, i cili përfshinte ndërtimin e një sistemi të ri në pjesën e sipërme të fshatit Përlepnice, në vendin e quajtur "Guri i Hoxhës", afërsisht 5 km nga fshati. Në vitin 1978, projekti për furnizimin me ujë të pijshëm mori një hap vendimtar me ndërtimin e pendës në Përlepnice, projekt i cili zgjati deri në fund të vitit 1983. Gjatë kësaj

kohe, u ndërtua edhe një fabrikë për pastrimin e ujit të pijshëm, e cila kontribuoi ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së furnizimit.

Pas përfundimit të luftës, në fund të vitit 1999, komuniteti ndërkombëtar, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, filloi procesin e riorganizimit të ndërmarrjeve publike. Kjo përfshiu shndërrimin e tyre në kompani publike të menaxhuara me standarde moderne. Fillimisht, u kryen studime mbi gjendjen e ujësjellësve në të gjithë Kosovën, dhe më pas, në bashkëpunim me partnerë të shumtë ndërkombëtarë, filloi riorganizimi dhe rimëkëmbja e tyre. Si rezultat, u themeluan shtatë Kompani Rajonale të Ujësjellësit dhe të Kanalizimit për të mbuluar të gjitha rajonet e Kosovës.



Në vitin 1971, nisi një projekt për zgjerimin e kapaciteteve të ujit të pijshëm për Gjilanin, i cili përfshinte ndërtimin e një sistemi të ri në pjesën e sipërme të fshatit Përlepnice, në vendin e quajtur 'Guri i Hoxhës', afërsisht 5 km nga fshati.

Në juglindje të Kosovës, për riorganizimin e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidromorava," një rol kyç pati Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Swiss Agency for Development and Cooperation - SDC), e cila ofroi mbështetje të vazhdueshme për të ndihmuar në rimëkëmbjen dhe

zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj Kompanie. Ky partneritet kontribuoi në ndërtimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e shërbimeve për komunitetin, duke siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe të cilësisë së lartë me ujë të pijshëm për qytetarët e Gjilanit dhe zonat përreth.

2.1. Misioni i kompanisë

Misioni i Kompanisë është të sigurojë një furnizim të qëndrueshëm, të sigurt dhe me cilësi të lartë të ujit të pijshëm për të gjithë konsumatorët e saj, në përputhje të plotë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të shëndetit dhe sigurisë. Kompania angazhohet të ofrojë ujë të mjaftueshëm dhe të cilësisë së duhur për çdo përdorues të lidhur në sistem, pa dallim race, gjinie apo besimi fetar, duke e konsideruar këtë një të drejtë themelore për të gjithë.

Në përputhje me këtë, Kompania synon të ofrojë shërbime cilësore në grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotura, duke mbrojtur shëndetin publik dhe përmbushur standardet më të larta të mbrojtjes së mjedisit. Duke trajtuar dhe shkarkuar ujërat e ndotura në mënyrë të sigurt, Kompania përpiqet të kontribuojë në ruajtjen e mjedisit dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë komunitetin që ajo shërben.

Për më tepër, Kompania synon të përmirësojë vazhdimisht performancën e saj financiare, për të arritur një qëndrueshmëri të plotë ekonomike. Objektivi është të sigurohet që Kompania të ketë likuiditetin e nevojshëm për të mbuluar shpenzimet operacionale dhe për të përmbushur nevojat e saj për investime kapitale. Përmes përmirësimit të vazhdueshëm të gjendjes financiare, Kompania synon të jetë e aftë të tërheqë financime shtesë, përfshirë edhe kredinë, për të investuar në përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës, duke garantuar kështu një zhvillim të qëndrueshëm për të ardhmen.

Këto përpjekje kolektive ndihmojnë në realizimin e vizionit të Kompanisë për të qenë një ofrues i besueshëm i shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, që kontribuon në mirëqenien e komunitetit dhe në mbrojtjen e burimeve ujore.

3.1. Rreziqet e Kompanisë

Realizimi i misionit të Kompanisë për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor të ujit mund të hasë në një sërë rreziqesh të natyrave të ndryshme, të cilat mund të ndikojnë në aftësinë për të përmbushur objektivat e saj. Disa nga këto rreziqe përfshijnë:

- Mungesa e ujit për shkak të mungesës së reshjeve atmosferike: Në kushtet e ndryshimeve klimatike, reshjet atmosferike janë bërë më të paparashikueshme dhe shpesh të pamjaftueshme. Kjo mund të çojë në mungesa

të konsiderueshme të burimeve ujore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetin e furnizimit të Kompanisë.

- Kriza socio-ekonomike në nivel kombëtar ose lokal: Në rast të një krize ekonomike, mund të ketë ndikime të ndjeshme në aftësinë e konsumatorëve për të paguar faturat e ujit, si dhe në buxhetet e disponueshme për mirëmbajtje dhe investime. Një krizë e tillë mund të ulë edhe të ardhurat e Kompanisë, duke kufizuar mundësitë për përmirësim dhe zgjerim të infrastrukturës.

- Shfaqja e pandemive që ndikon në të ardhurat: Pandemitë si COVID-19 mund të shkaktojnë ndërprerje të konsiderueshme në aktivitetet ekonomike dhe sociale, duke ndikuar negativisht në të ardhurat e Kompanisë si rezultat i mosrealizimit të pagesave dhe uljes së konsumit. Pandemitë mund të çojnë gjithashtu në kosto shtesë për ruajtjen e sigurisë dhe shëndetit të stafit.
- Mungesa e gatishmërisë së donatorëve për të financuar projektet investive: Nëse donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat financiare nuk janë të gatshëm të mbështesin projektet e nevojshme investive, kjo mund të ndikojë negativisht në mundësinë e Kompanisë për të modernizuar dhe zgjeruar shërbimet e saj. Financimi i jashtëm është shpesh thelbësor për projektet e mëdha kapitale që kërkohen për të përmirësuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me ujë.
- Fatkeqësitë natyrore të papritura: Fenomene si tërmetet, përmbytjet, thatësira e zgjatur, apo rrëshqitjet e tokës mund të shkaktojnë dëmtime të konsiderueshme në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit. Fatkeqësitë natyrore jo vetëm që sjellin kosto të larta për riparime dhe rehabilitimin e aseteve, por gjithashtu

rrezikojnë ndërprerjen e furnizimit me ujë dhe shkarkimin e ujërave të ndotura.

- Përballja me këto rreziqe kërkon një planifikim të kujdesshëm dhe qasje proaktive. Kompania angazhohet të ndërmarrë masa të duhura për të zvogëluar ndikimin e këtyre rreziqeve, duke përfshirë përdorimin e teknologjive të përparuara, zhvillimin e planeve të reagimit të shpejtë, si dhe bashkëpunimin me institucione dhe partnerë të jashtëm për të siguruar qëndrueshmërinë e shërbimeve në çdo rrethanë.

Objektivi është që Kompania të ketë likuiditetin e nevojshëm për të mbuluar shpenzimet operationale dhe për të përmbushur nevojat e saj për investime kapitale. Përmes përmirësimit të vazhdueshëm të gjendjes financiare, Kompania synon të jetë e aftë të tërheqë financime shtesë, përfshirë edhe kredinë, për të investuar në përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës, duke garantuar kështu një zhvillim të qëndrueshëm për të ardhmen.

Këto përpjekje kolektive ndihmojnë në realizimin e vizionit të Kompanisë për të qenë një ofrues i besueshëm i shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, që kontribuon në mirëqenien e komunitetit dhe në mbrojtjen e burimeve ujore.



2. OBJEKTIVAT AFATGJATË STRATEGJIKE TË KOMPANISË

KRU Hidromorava sh.a. përfshin Qendrën Regjionale në Gjilan dhe dy njësi operative në Viti dhe Kamenice. Kompania funksionon duke respektuar parimet e qeverisjes korporative, me vendimmarrje dhe llogaridhënie të rregullt ndaj Bordit të Drejtorëve dhe Njësisë për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike. Këto struktura sigurojnë mbikëqyrje dhe drejtim të vazhdueshëm të Kompanisë, duke e bërë të mundur qëllimin e ofrimit të shërbimeve cilësore për konsumatorët e saj.

Bordi i Drejtorëve, në bashkëpunim me menaxhmentin, ka përcaktuar një sërë objektivash strategjike për të udhëhequr KRU Hidromorava Sh.A. drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm për periudhën 2025-2027. Objektivat kryesore përfshijnë:

a. Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit në zonën e shërbimit: KRU Hidromorava Sh.A. synon të përmirësojë kapacitetet e furnizimit me ujë për të plotësuar nevojat në rritje të zonës së shërbimit, duke investuar në burime të reja dhe në menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve ekzistuese.

b. Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale: Duke përmirësuar infrastrukturën dhe duke zbatuar teknologji moderne për monitorimin e rrjedhave dhe menaxhimin

e presionit, Kompania synon të reduktojë humbjet e ujit dhe të maksimizojë efikasitetin operativ.

c. Arkëtimi i borxheve të vjetra: Për të përmirësuar stabilitetin financiar, KRU Hidromorava Sh.A. do të implementojë strategji efektive për arkëtimin e borxheve të vjetra, duke përdorur qasje proaktive dhe mjete të avancuara të menaxhimit të borxhit.

d. Rritja e shkallës së faturimit dhe arkëtimin: Për të siguruar të ardhura të qëndrueshme dhe për të mbuluar shpenzimet operationale, Kompania do të përmirësojë proceset e faturimit dhe të arkëtimin, duke angazhuar staf të trajnuar dhe teknologji të përditësuar.

e. Avancimi i sistemit informativ gjeografik (GIS): KRU Hidromorava Sh.A. do të vazhdojë përmirësimin e sistemit GIS për të mbuluar tërë zonën e shërbimit, duke mundur monitorim më të detajuar dhe planifikim efektiv të aseteve. Ky proces do të përfshijë gjithashtu hartimin dhe implementimin e një Plani të Menaxhimit të Aseteve.

f. Mirëmbajtja e rregullt e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit: Me qëllim të garantimit të cilësisë së shërbimeve, Kompania do të vazhdojë programin e mirëmbajtjes së rregullt të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, duke përfshirë inspektime të shpeshta dhe riparime

të menjëhershme për të shmangur ndërprerjet e shërbimit.

g. Përputhja me Rregulloret e ARRU-së: KRU Hidromorava do të adoptojë plotësisht rregulloret e rekomanduara nga ARRU, përfshirë Standardet Minimale të Shërbimeve, Licencimin, Kartën e Konsumatorëve dhe Politikat Tarifore. Ky angazhim siguron që shërbimet të ofrohen me cilësi të lartë dhe në përputhje me normat rregullatore.

h. Rritja e transparencës në raportim: Kompania do të përmirësojë transparencën në raportimet që u ofrohen Bordit të Drejtorëve dhe palëve të tjera të interesuara, duke siguruar informacione të sakta dhe të azhurnuara për performancën dhe projektet e saj.

i. Rritja e qëndrueshmërisë financiare: Në përpjekje për të forcuar qëndrueshmërinë financiare, Kompania do të rrisë normën e

mbulimit të punës për të siguruar që mundësitë për investime të jenë në rritje dhe që financat të mbeten të qëndrueshme në periudhën afatgjatë.

j. Rritja e vlerës së asetëve për periudhën 2025-2027: Përmes investimeve të donatorëve, qeverisë dhe burimeve vetanake, Kompania synon të rrisë vlerën e asetëve të saj, duke kontribuar kështu në forcimin e infrastrukturës dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofron.

Këto qëllime strategjike përcaktojnë një rrugë të qartë për zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të KRU Hidromorava, me fokus në ofrimin e shërbimeve të cilësisë së lartë dhe në përmbushjen e nevojave të komunitetit që ajo shërben.

Për realizimin e objektivave kryesorë strategjikë, për periudhën 2025-2027, Kompania ka paraparë përmbushjen e treguesve në vijim të përcaktuar në koordinim me ARRU:

Tabela 1 Treguesit e Performancës

Treguesit kryesor të performancës	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027
Ujë i pa faturuar-si përqindje	%	52.08	39.20	47.50	46.00	45.00
Norma e arkëtimit - e përgjithshme	%	86.00	93.80	96.00	96.00	96.00
Norma e arkëtimit - amvisëritë	%	83.00	93.00	95.00	95.00	96.00
Norma e arkëtimit - biznese	%	100.00	97.00	100.00	100.00	100.00
Norma e arkëtimit -Institucione	%	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
Norma e mbuleses së punës	Numër	1.28	1.28	1.33	1.45	1.45
Përqindja e konsumatorëve me lexim	%	99.99	99.99	100.00	100.00	100.00
Staf për 1000 konsumatorë	Numër	4.10	4.24	4.28	4.25	4.25

2.1. Projeksionet nga viti 2024 dhe parashikimi 2025

Tabela 2 Planifikimet sipas procesit tarifor 2024 (shprehur në '000 m³ ose '000 euro)

Nr	Treguesi	X 1000 m ³ ose X 1000 € ¹		Plani i rritjes në %
		2024	2025	
1	Prodhimi i ujit (m ³)	8,025	9,178	14.37
2	Faturimi i ujit (m ³)	4,879	4,821	-1.19

¹ Të aprovuara nga ARRU sipas procesit tarifor.

PLANI I BIZNESIT - KRU "HIDROMORAVA" Sh.A. GJILAN, 2025-2027

3	Uji i pa faturuar (m ³)	3,146	4,357	38.49
4	Faturimi €	2,720	3,049	12.10
5	Arkëtimi €	2,519	2,927	16.20
6	Përqindja e arkëtitimit (%)	93.56	96.00	2.61
7	Shpenzimet (€)	2,167	2,292	5.77
8	Numri i konsumatorëve të regjistruar	44,676	42,763	-4.28
9	Konsumatorë aktiv (numër)	39,350	41,319	5.00
10	Konsumatorë me UM (numër)	39,338	41,308	5.01
11	Konsumatorë me UM (%)	99.97	99.99	0.02
12	Përqindja e ujit të faturuar	60.80	52.5	-13.65
13	Përqindja e ujit të pa faturuar (humbja)	39.20	47.5	21.17
14	Norma e mbulimit të punës(4/7)	1.26	1.33	5.56

Tabela 3 Pasqyra e të ardhurave , planifikimi 2024 /2025

	Realizimi 2024	Planifikimi 2025
Të hyrat nga faturimi	2,720,733.00	3,049,378.00
Të hyrat e tjera	69,481.33	77,819.09
Total të ardhurat	2,790,214.33	3,127,197.09
Kategorizimi i shpenzimeve		
Ngarkesa për shërbime ndaj, ARRU, MMPH, SHUKOS	(41,826.00)	(42,777.00)
Shpenzimet e materialit dhe të materieve të konsumueshme	(164,085.00)	(168,698.00)
Shpenzimet e shërbimeve të kontraktuara	(63,999.00)	(64,998.00)
Shpenzimet e energjisë	(287,090.00)	(291,180.00)
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe të riparimit	(80,280.00)	(71,294.00)
Shpenzimet e derivateve	(51,267.00)	(54,808.00)
Shpenzimet e pagave	(1,495,664.00)	(1,565,664.00)
Shpenzimet tjera direkte dhe indirekte	(44,998.00)	(33,005.00)
Total shpenzimet operative	(2,229,209.00)	(2,292,424.00)
Shpenzimet e provizionimit (borxh i keq)	(50,000.00)	(50,000.00)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(666,572.00)	(716,557.00)
Te hyrat nga grantet	435,117.00	485,102.00
Fitimi para tatimit	269,550.00	553,318.09

PLANI I BIZNESIT - KRU "HIDROMORAVA" Sh.A. GJILAN, 2025-2027

Tabela 4 Performanca nëntë mujore, për vitin 2024 (shprehur në "000 m3 ose "000 euro)

Nr	Performanca e KRU "Hidromorava" SH.A.- Gjilan X1000 m3 dhe X1000 €	Nëntë mujori i real- izuar 2024	Nëntë mujori i planifi- kuar 2024	Realizimi i planit nëntë mujor 2024 në %
1	Prodhimi i ujit m ³	6,928	6,205	111.65
2	Faturimi i ujit m ³	3,317	3,799	87.31
3	Uji i pafaturuar (humbja)	3,611	2,406	66.62
4	Faturimi €	1,882	2,097	89.75
5	Arkëtimi €	2,037	1,962	103.82
6	Përqindja e arkëtitimit(%)	108.24	93.56	115.68
7	Shpenzimet €	1,649	1,648	100.06
8	Konsumatorëve të regjistruar (numër)	43,017	42,200	101.94
9	Konsumatorë aktivë (numër)	39,141	39,080	100.16
10	Konsumatorëve me UM (numër)	38,893	39,030	99.65
11	Përqindja e konsumatorëve me UM	99.37	99.87	99.49
12	Përqindja e ujit të faturuar	47.88	61.22	78.2
13	Përqindja e ujit të pa faturuar (humbja)	52.12	38.78	74.401
14	Norma e mbulimit të punës (4/7)	1.14	1.27	89.76



3. MASAT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE

3.1 Objektiva e parë - "Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit"

Sa i përket objektivës së parë - sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit, Kompania nuk ka mundësi as financiare as njerëzore të realizoj këtë objektivë. Për arritjen e këtij qëllimi Kompania do të mbështetet nga burimet e jashtme qofshin ato qeveritare apo kontributi i donatorëve. Pra Qeveria është duke punuar në dy drejtime:

- Projekti i Ndërtimit të digës së Firajës dhe sigurimi i ujit për rajonet Gjilan, Ferizaj dhe Prishtina, i financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe
- Projekti FLOWS, i financuar nga Banka Botërore studimi i fizibilitetit është në proces për pendën në komunën e Kamenicës.

3.2 Objektiva e dytë - "Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit"

Humbjet e ujit paraqesin një sfidë kyçe për Kompaninë tonë dhe viti 2025 është një periudhë kritike për të arritur cakun e zvogëlimit të ujit të pafaturuar (UPF) në nivelin e përcaktuar prej 47% nga Autoriteti Rregullativ për Ujërat. Ne do të vazhdojmë të përqendrohemi në identifikimin e lidhjeve të paautorizuara, parandalimin e keqpërdorimeve, instalimin e

ujëmatësve zonalë, dhe zbatimin e masave të tjera të caktuara në përputhje me rregulloret e Autoritetit Rregullator për ujërat. Ky angazhim është thelbësor për të siguruar efikasitetin dhe kontrollin e humbjeve të ujit, duke garantuar një menaxhim të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm të burimeve të ujit në shërbim të komunitetit tonë dhe për të përmbushur standardet rregullatore vendore.

Projekti FLOWS sjell një përparim të rëndësishëm në menaxhimin e ujërave të kompanisë tonë. Disa veprime kyçe që do të ndërmerren në periudhën 2025-2027 për të përmirësuar efikasitetin dhe zvogëlimin e humbjeve të ujit janë:

- » Ndërrimi i gypave kryesorë të ujësjellësit në Gjilan dhe Kamenicë që është paraparë në projektin FLOWS dhe pritet që kjo ndërhyrje do të zvogëlojë humbjet teknike dhe të eliminojë lidhjet ilegale nëpër këta gypa,
- » Ndërtimi i rezervuarit me kapacitet 3500 m³ tek fabrika e përpunimit të ujit në Përlepnice si dhe ndërtimi dhe shtimi i kapaciteteve të fabrikës së përpunimit të ujit në Letnicë për 60l/s.
- » Ngritja e efijencës së stacioneve të pompimit Baja, Burgu, Velekincë dhe Përlepnice.
- » Vendosja e matësve zonal dhe zbulimi i lidhjeve ilegale, krijimi i një zone për matjen e konsumit të ujit një zone gjerë të

caktuar gjeografike ose distrikti (DMA - District Metered Area), me matës zonal do të ndihmojë në identifikimin dhe monitorimin e konsumit dhe lidhjeve ilegale. Përfshirja e një numri të konsiderueshëm të konsumatorëve në këto zona matëse do të ndikojë në zbulimin e humbjeve të ujit.

- » Vendosja e ujëmatësve smart me sigurimin e fondeve shtesë nga projekti FLOWS.
- » Inspektimi dhe detektimi i kyçjeve ilegale, përpjekjet për inspektim dhe detektim të kyçjeve ilegale dhe vjedhjeve të ujit do të intensifikohen për të parandaluar keqpërdorimet.
- » Shkyçja dhe legalizimi i personave të kyçur ilegalisht.
- » Inspektimi i rregullt dhe zëvendësimi i ujëmatësve jofunksional, po ashtu edhe ndërrimi i një numri të ujëmatësve që janë më të vjetër se 5 vite për shkak të mundësisë së matjes jo të saktë të konsumit për shkak të amortizimit.
- » Ngritja e saktësisë dhe përgjegjësisë në leximin e ujëmatësve, dhe rritja e nivelit të përgjegjësisë në trajtimin e dëmtimeve sipas rregullores së Autoritetit Rregullativ për Ujërat
- » Riparimi më i shpejtë i rrjedhjeve sipërfaqësore dhe identifikimi i rrjedhjeve nëntokësore, veprime të ndërmarra për riparimin e rrjedhjeve sipërfaqësore dhe identifikimin e rrjedhjeve nëntokësore do të kontribuojnë në zvogëlimin e humbjeve të ujit.

3.3 Objektiva e tretë - "Arkëtimi i borxheve"

Arkëtimi i borxheve është një objektive themelore për menaxhimin financiar. Numri i konsumatorëve debitorë ndaj Kompanisë është rreth 9,700 konsumatorë me një borxh total që tejkalon 6 milion euro. Aktivitetet për menaxhimin e këtyre borxheve do të vazhdojnë sipas një plani të veprimit, i cili përfshinë:

Telefonatat: Kompania ka nisur një fushatë intensive gjatë vitit 2023 dhe do të vazhdojë edhe në vitin 2025, me qëllim njoftimin e konsumatorëve për borxhet dhe arritjen e marrëveshjeve për pagesë. Ky aktivitet ka rezultuar i suksesshëm, pasi deri më tani janë arritur marrëveshje me rreth 3,950 konsumatorë, me një vlerë që tejkalon 2.7 milion euro, kryesisht për borxhe më të vjetra se një vit.

Vërejtjet: Kjo përfshin dërgimin e njoftimeve zyrtare për të informuar konsumatorët mbi borxhet dhe pasojat nëse nuk kryhet pagesa në kohë.

Shkyçjet: Gjatë vitit 2025 do të shtohen tre ekipe të reja, secila e përbërë nga dy anëtarë duke e rritur në gjashtë numrin total të ekipeve aktive. Këto ekipe do të ndahen në gjashtë zona specifike, dhe secili ekip do të jetë përgjegjës për zonën përkatëse. Nëse konsumatorët nuk reagojnë ndaj vërejtjeve dhe nuk kryejnë pagesat, do të ndërmerren masa për shkyçjen e tyre nga shërbimi.

Procedura Përmbartimore: Për të siguruar arkëtimin e borxheve nga konsumatorët që nuk i përgjigjen detyrimeve për shërbimet e ofruara, do të nisen procedurat përmbartimore. Qëllimi është të arrihen marrëveshje pagese, duke mundësuar një menaxhim më efikas të këtyre detyrimeve.

Paditë Penale: Në rastet kur hapat e përmendur nuk japin rezultat, do të ndiqet procedura ligjore përmes gjykatave për të kërkuar detyrimet e papaguara.

3.4 Objektiva e katërt - "Rritja e shkallës së faturimit dhe arkëtimimit"

Plani i arkëtimimit për vitin 2025 parasheh që të arkëtohet 96% e ujit të faturuar. Kjo synohet të arrihet përmes mobilizimit të të gjithëve, veçanërisht stafit të ekipit për shkyçje të konsumatorëve që nuk i kryejnë obligimet për ujin e shpenzuar. Plani i arkëtimimit do të përfshijë përdorimin e metodave të ndryshme për të organizuar arkëtimin e mjeteve.

Kompania do të aplikojë masa më të ashpra në rastet

kur konsumatorët nuk bëjnë pagesat e tyre, me një fokus të veçantë në kategoritë e konsumatorëve shtëpiak-amvisëritë, bizneset e vogla dhe institucionet.

Në përpjekje për të adresuar sfidat, do të kemi një qasje të veçantë ndaj kategorisë së konsumatorëve-shtëpiak, për t'u përballur me problemet e mospagesës së ujit të harxhuar përmes masave të mëposhtme:

- » Përmirësimi i sistemeve të monitorimit dhe të pagesës së konsumit të ujit.
- » Zbatimi i një politike më të rreptë për pagesën e borxheve të vonuara.
- » Ndërmarrja e fushatave informuese ndaj konsumatorëve për rëndësinë e pagesës me kohë të ujit të konsumuar .

Tabela 5 Planifikimi i performancës operative për vitin 2025

Treguesit Operativë	Plan Bizensi 2025
Prodhimi i ujit në m ³	9,178,157.00
Faturimi i ujit (%)	52.50
Arkëtimi i ujit (%)	96.00
Uji i pa faturuar (%)	47. 50
Testet e dështuara (%)	0.00
Konsumatorë me Ujëmatës (%)	99.99
Numri i konsumatorëve të regjistruar	42, 763
Numri i punëtorëve	177



4. TARIFAT E SHËRBIMIT

Kompania Rajonale e Ujësjesit Hidromorava Sh. A. zbaton tarifën që vendos Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit (ARRU). Në bazë të tarifave/

çmimeve aktuale, duke marrë në konsideratë prodhimin, shkallën e arkëtimit, nivelin e humbjeve komerciale dhe teknike mund bëhet në tërësi mbulimi i kostove operative.

Tabela 6 Tarifat

		2022	2023	2024	2025
Shtëpiak - tarifa fikse mujore	EUR/kons/muaj	1	1	1	1
Shtëpiak -volumetrike	EUR/m ³	0.35	0.35	0.35	0.38
Komercial-industrial-tarifa fikse mujore	EUR/kons/muaj	2	2	2	2
Komercial-industrial-volumetrike	EUR/m ³	0.52	0.52	0.52	0.54
Institucional- tarifa fikse mujore	EUR/kons/muaj	2	2	2	2
Institucional-volumetrike	EUR/m ³	0.52	0.52	0.52	0.54
Ujërat e ndotura (vëllimi i ujit të konsumuar)					
Shtëpiak	EUR/m ³	0.08	0.08	0.08	0.12
Komercial-industrial	EUR/m ³	0.17	0.17	0.17	0.27
Institucional	EUR/ m ³	0.17	0.17	0.17	0.27
Tarifat kumulative					
Shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)	EUR/ m ³	0.43	0.43	0.43	0.50
Jo-shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)	EUR/ m ³	0.69	0.69	0.69	0.81



5. PLANI I MENAXHIMIT TË ASETEVE

Plani për menaxhimin e aseteve (PMA) përfshin vlerësimin e aseteve nëntokësore dhe mbitokësore nga kategoritë e strukturave ndërtimore si ndërtesat e stacioneve të pompimit, rezervuarët, pompat, valvolat, veturat, pajisjet elektrike dhe pjesë tjera më të imta si dhe rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Momentalisht asetet janë vlerësuar në katër kategori ku janë përcaktuar shërbyeshmëria (gjendjen dhe performancën) dhe kritikaliteti (gjendja kritike e asetit) (pasojat dhe dështimet) dhe në fund është bërë radhitja e aseteve më kritike. Kjo listë njëherit duhet të jetë edhe lista prioritare për të bërë planin e investimeve. Kjo listë gjendet tek pjesa e investimeve në kuadër të dokumentit.


Vlerësimi i aseteve të infrastrukturës nëntokësore për rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit është realizuar përmes Modelit Builder¹ si proces i automatizuar përmes GIS-it. Përtëbërë vlerësimin

¹ Model Builder- ModelBuilder është një gjuhë programimi vizuale për menaxhimin e të dhënave përmes automatizimit të proceseve gjeohapësinore.

sa më të saktë dhe automatik sipas kërkesave të rregullatorit është përdorur metodologjia e bazuar në këto kritere:

1. Materiali i gypave: është realizuar vlerësimi i materialit të gypave nga AC deri në HDPE RC;
2. Diametri i gypave: është realizuar vlerësimi i diametrit të gypave për nga rëndësia (diametri më i madh rëndësia më e madhe);
3. Viti i instalimit të gypave: është analizuar moshja e gypave dhe amortizimi (jetëgjatësia);
4. Numri i defekteve në gyp: është analizuar numri i defekteve në gyp për të dhënat që i posedojmë.

Në bazë të këtyre kritereve është ndërtuar modeli i automatizuar i cili në kohë reale jep të dhënat e kërkuara. Në hartën e mëposhtme janë paraqitur gypat të cilat i ka gjeneruar modeli. Kritikaliteti është paraqitur me ngjyra dhe atë në gjashtë rangje të parazgjedhura, ku rangu më i lartë paraqet gjendjen kritike më të padëshiruar dhe që është e kuqe.



Harta 2 Vlerësimi i Aseteve Nëntokësore



6. GJENDJA AKTUALE E PERSONELIT

6.1. Struktura kualifikuese e të punësuarëve

Aktualisht KRU "Hidromorava" Sh. A. operon me 166 punëtorë, nga të cilët 128 në Gjilan, 20 në Viti dhe

18 në Kamenicë, të ndarë në tre departamente:

Departamenti Teknik, Financiar dhe Departamenti i Administratës. KRU "Hidromorava" Sh. A. ka këtë strukturë të kualifikimit të punësuarve:

Tabela 7 Gjendja aktuale e personelit

Stafi i KRU "Hidromorava" Sh.A., tetor 2024				
Totali:	166	M: 142	F: 24	
	Gjilan	Viti	Kamenice	Total
Master	6	0	1	7
Fakulteti	11	1	2	14
Bachelor	13	2	1	16
Shkollë e Mesme	81	17	13	111
Shkollë Fillore	16	0	2	18


6.1.1. Struktura e moshës së të punësuarve

Bazuar në të dhënat e fundit mbi strukturën e moshës së punonjësve në KRU Hidromorava Sh.A, deri në fund të muajit shtator 2024, rreth 57.22%

e stafit është mbi moshën mesatare (50-65 vjeç). Ky tregues tregon nevojën për rekrutimin e stafit të ri për të siguruar ngritjen e performancës dhe qëndrueshmërinë e operimit afatgjatë të kompanisë.

Tabela 8 Moshë e të punësuarve

Moshë e punëtorëve	Numri i Punëtorëve	Përqindja
20-29	3	1.81%
30-39	28	16.86%
40-49	40	24.10%
50-59	65	39.15%
60-65	30	18.07%



Grafiku 1 Mosha e të punësuarve

6.1.2. Numri i të punësuarve që do të pensionohen për vitet 2025-2027

Tabela 9 Numri i të punësuarve që do të pensionohen 2025-2027

Pozita	Viti 2025
Zyrtare për burime njerëzore	1
Zyrtar ligjor	1
Arkëtar	1
Arkëtar NJO Viti	1
Lexues ujëmatësve	1
Punëtor në mirëmbajtje të kanalizimit	1
Pozita	Viti 2026
Lexues ujëmatësve	1
Depoist	1
Pozita	Viti 2027
Menaxher Divizionit të Financave	1
Laborant/e	2
Arkëtar NJO Kamenicë	1
Mjeshtër në rretin e ujësjellësit	2
Punëtor	1
Operator	1
Punëtor në mirëmbajtje të kanalizimit	1
Roje	2

6.2. Nivelet e aftësisë dhe programet e trajnimit

Riorganizimi i punës, transferimi i punëtorëve në shërbime të planifikuara, ndryshimet e vazhdueshme strukturore që kanë si synim fleksibilitet më të madh në punë dhe përshtatje me mjedisin e punës janë treguesit kryesor që trajnimi dhe zhvillimi i stafit të jetë një proces i vazhdueshëm me ndikim pozitiv në rritjen e efikasitetit të KRU "Hidromorava" Sh.A. Përmes këtij procesi synohet të arrihet një përmirësim i aftësive dhe një kualifikim profesional i punëtorëve, sepse çdo punë ka specifikat e veta.

KRU "Hidromorava" Sh. A. në nivel të Kompanisë do të organizojë brenda sektorëve trajnime për punëtorët nga përgjegjësit e sektorëve

6.3 Programet e rekrutimit

Suksesi dhe përshtatshmëria e një kompanie ndër të tjera varet edhe nga rekrutimi i punonjësve, të cilët duhet të jenë profesional dhe të përkushtuar në punë. Prandaj KRU "Hidromorava" Sh.A. parasheh që për shkak të rritjes së numrit të konsumatorëve dhe vëllimit të punëve të bëjë rekrutimin e punonjësve të nevojshëm për sektorët e veçantë në kuadër të Kompanisë.

Menaxhmenti i Kompanisë konsideron se resurset njerëzore nuk janë ende në nivelin e kërkuar sa i përket anës profesionale dhe këto aspekte të stafit do të adresohen gjatë viteve planifikuese 2025-2027. Bazuar në Ligjin mbi Financat Publike kërkohet të plotësohet pozita e Certifikuesit të pagesave, për shkak të sigurisë për ekzekutimin e tyre, pozitë e cila është e domosdoshme për të plotësuar kriteret për implementimin e projekteve në tri vitet e ardhshme siç janë FLOWS dhe Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura.

Kompania aktualisht ka normën e mbulimit të punës 4.24 për 1,000 konsumatorë aktiv. Deri në fund të vitit 2025 Menaxhmenti i Kompanisë parasheh plotësimin në strukturën organizative

dhe nga ana e drejtuesve të departamenteve në vazhdimësi. Po kështu është menduar që të organizohet pjesëmarrja në trajnime në ngritjen profesionale të shërbimit financiar dhe atij teknik nga ana e Shoqatës së Ujësjetësve dhe Kanalizimit të Kosovës siç janë organizuar edhe më parë. Nevojat e trajnimeve janë evidente si në Menaxhment ashtu edhe në sektorët financiar, teknik, prokurim dhe administrativ.

Gjatë vitit 2025 do të shikohet mundësia e organizimit të trajnimeve menaxheriale si p.sh menaxhimit modern të burimeve njerëzore, menaxhimit financiar, GIS, mirëmbajtjen e rrjetit të furnizimit me ujë, reduktimin e humbjeve në rrjet, menaxhimit të sistemit informativ dhe trajnime tjera.

duke i dhënë rëndësi më të madhe kontrollit në terren, leximit të ujëmatësve, si dhe forcimit të sektorit të shkyqjes si mjet për rritjen e arkëtimit dhe të të ardhurave të Ndërmarrjes.

Po ashtu duke u bazuar në planet për zgjerimin e zonës së shërbimit, fillimi për ndërtimin e Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, Kompania parasheh të punësoj një numër të punonjësve të ri gjatë periudhës 2025-2027:

- një (1) Drejtor Teknik
- një (1) Drejtor Komercial
- një (1) zyrtar certifikues
- një (1) zyrtar për raportim
- një (1) shef i lexuesve
- një (1) zyrtar për mbledhje të të dhënave
- gjashtë (6) punëtor për kontroll dhe shkyqje
- dy (2) inspektor dhe kontrollor
- tre (3) inxhinier të hidros (Viti, Gjilan, Kamenicë)
- një (1) mikrobiolog/e për analiza

- mikrobiologjike
- pesë (5) mjeshtër ujësjellësi (Gjilan-4 , Kamenicë-1)
- htatë (7) punëtorë fizik për ujësjellës(Gjilan-4, Viti -1, Kamenicë-2)
- gjashtë (6) lexues (Gjilan -5,Kamenicë-1)
- tre (3) punëtor fizik për kanalizim
- një (1) vozitës ekskavatori / cisterna
- dy (2) mirëmbajtës-e, Viti dhe Kamenicë

Tabela 10 Rekrutimi i stafit të ri për vitin 2025

Pozita	Viti 2025
Drejtor Teknik	1
Zyrtar Certifikues	1
Inxhinier të hidros NJO Viti	1
Punëtor për kontroll dhe shkycje	2
Zyrtar për mbledhje të dhënave në zyrën e GIS-it	1
Mjeshtër të rrjetit të ujësjellësit	5
Total	11

Koha e rekrutimit do të përcaktohet në bazë të progresit të punëve dhe gjendjes financiare të Kompanisë. Në vitin 2025 planifikohet rekrutimi i pozitave: drejtor teknik, zyrtari certifikues, inxhinier, punëtor për shkycje dhe kontroll, mjeshtër dhe zyrtar për mbledhje të dhënash në zyrën e GIS-it, ndërsa plotësime tjera varësisht siç do të jetë performanca e kompanisë do të bëhet krahas nevojave që ndikojnë në ngritje edhe më të lartë të performancës, në bazë të rritjes së zonës së shërbimit dhe aktiviteteve të rritura të mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit dhe

kanalizimit. Në këtë kontekst, parashihet nevoja për katër lexues shtesë për të përmbushur synimet e rritjes së faturimit dhe zgjerimit të zonës së shërbimit.

KRU "Hidromorava" Sh. A, ka përgatitur skemën funksionale - ORGANOGRAMIN i cili përputhet me strategjinë zhvillimore sepse rolet dhe përgjegjësitë janë të specifikuara mirë. Struktura e përgatitur do të prodhojë efikasitet në menaxhimin e Kompanisë ashtu siç është paraqitur në skemën organizative të paraqitur në faqen pasuese.





7. PRODHIMI I UJIT PËR VITIN 2025

Produktimi i planifikuar për vitin 2025 do të bazohet në mesatarën e prodhimit për nëntë muajt e parë të vitit 2024, me një mesatare për muaj rreth 767,000 m³, plani për vitin 2025 mund të arrihet mbi 9.240,000 m³

. Megjithatë, duke pasur parasysh se kërkesa për konsum të ujit mund të jetë më e lartë, duhet të zvogëlojmë humbjen e ujit për të siguruar që të ruajmë sasinë e ujit të prodhuar dhe të plotësojmë nevojat për ujë.

Grafiku 2 Prodhimi i ujit për vitin 2025



7.1 Kualiteti i ujit të pijshëm në kuadër të Zonës së Shërbimit

Kualiteti i ujit të pijshëm i shpërndarë në tërë zonën e shërbimit monitorohet rregullisht nga ekipet e specializuara të KRU Hidromorava në Gjilan por edhe nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike.

Në impiantet e trajtimit të ujit në Përlepnice, Velekinçë dhe Letnicë janë të vendosura pajisjet për monitorim online të parametrave primar për cilësi të ujit. Kompania brenda vitit duhet të investojë në rehabilitimin e tyre pasi që disa nuk janë funksional dhe disa të tjerë duhen të kalibrohen.

Gjatë viteve 2025-2027 Kompania planifikon të përmirësojë ende cilësinë e ujit të pijshëm për të arritur shkallën deri në 100% të përmbushjes së standardeve të përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë. KRU "Hidromorava"

7.2 Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit

Krahas aktiviteteve të tjera, Kompania kujdeset për largimin e ujërave të ndotura të qyteteve të Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës përmes rrjetit shpërndarës dhe kolektorëve kryesor por pa ndonjë trajtim para shkarkimit. Ujërat e ndotura të qytetit të Gjilanit shkarkohen përmes dy kolektorëve kryesor në lumin Morava, ato të qytetit të Vitisë përmes kolektorit kryesor shkarkohen në lumin Morava, ndërsa ato të qytetit të Kamenicës përmes kolektorit shkarkohen

e ka përfunduar "Planin Operacional për menaxhim të Cilësisë së Ujit" e cila është aprovuar nga Qendra e Ujit në IKSHPK dhe aktualisht e zbatojmë këtë plan. Gjithashtu, në proces duke u punuar është edhe "Plani për Siguri të Ujit dhe Menaxhimi i Krizave".

në lumin Krivareka.

Kompania për të ardhmen do t'i kushtojë shumë rëndësi sektorit të kanalizimit si në investime po ashtu edhe në organizim në mënyrë që ky sektor të jetë shumë më efikas se deri me tani. Punët që priten të kryen nga këto ekipe janë:

- a) Inspektimi i pusetave të kanalizimit
- b) Riparimi i pusetave të kanalizimit
- c) Zhbllokimi dhe pastrimi






Figura 2 Skema e furnizimit me ujë Gjilan

LEGEND:

-  RESERVOIR
-  WATER TREATMENT PLANT
-  PUMPING STATION
-  GROUNDWATER WELL
-  SOURCE



8. SHËRBIMET PËR KONSUMATORË

Numri i konsumatorëve aktiv deri në shtator të vitit 2024 është 39,141 duke shënuar një rritje prej 1,752 në krahasim me periudhën e një viti më parë. Kjo rritje parashihet të vijojë në mënyrë të qëndrueshme në vitin 2025, ku parashihet që të arrihet një numër prej 42,763 konsumatorësh, e cila rritje do të jetë si rezultat i zgjerimit së zonës së shërbimit.

Gjatë periudhës planifikuese 2025, synojmë të shtojmë numrin e konsumatorëve të rinj, ku deri në fund të vitit parashihet të arrijmë 41,319 konsumatorë aktivë. Në vitin 2025, pritet që identifikimi i konsumatorëve ilegal të bëhet më i lehtë dhe efikas me përdorimin e sistemit GIS (Sistemi i Informacionit Gjeografik) në funksion të plotë. Kështu, përdorimi i GIS lexuesve dhe personelit të terrenit do të na mundësoj të identifikojmë të gjithë ata që përdorin ujin e pijshëm të ujësjellësit, po ashtu do të lehtësoj punën në inspektimin e kyçjeve të pa autorizuar-ilegale në rrjet. Po ashtu, planifikojmë të inspektojmë konsumatorët me konsum zero në mënyrë që të vërtetojmë gjendjen faktike pse janë me konsum zero.

Gjatë viteve 2023 dhe 2024, kompania ka vazhduar intensivisht përpjekjet për nënshkrimin dhe përditësimin e kontratave të shërbimeve për

ujësjellës dhe kanalizim, duke arritur deri tani mbi 10,000 kontrata të reja. Ky sukses është rezultat i punës së lexuesve në terren, si dhe angazhimit të stafit të administratës. Aktiviteti do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2025, me një plan të menaxhuar nga Divizioni i Konsumatorëve dhe Divizioni për Planifikim, ku në bashkëpunim me universitetet planifikohet angazhimi i studentëve dhe përmes platformat qeveritare për mbështetjen e punësimit të të rinjve.

Gjatë procesit të shkyçjeve, do të respektohet rregullorja e Autoritetit Rregullator për ujëra (ARRU) dhe do të ndihmohemi nga Policia e Kosovës-Gjilan për të siguruar ndihmën e duhur në rastet kur na paraqitet nevoja. Po ashtu, konsumatorët që nuk lejojnë shkyçjen teknike do të procedohen nëpërmjet rrugëve ligjore.

Kompania është përcaktuar për të përmirësuar shërbimin ndaj konsumatorëve dhe për të siguruar transparencën dhe bashkëpunimin me të gjithë akterët e sektorit të ujit. Shërbimi i marrëdhënieve me konsumatorë do të përparojë edhe më tej, përfshirë regjistrimin dhe raportimin elektronik të ankesave të konsumatorëve, si dhe kohëzgjatjen dhe shqyrtimin efikas të tyre në përputhje me standardet kohore.

8.1. Të ardhurat nga arkëtimi dhe shpenzimet operative²

Arkëtimi i ujit për vitin 2025 planifikohet të jetë 2,927,216 €, çka përkon me 96 % të vlerës së ujit të faturuar. Parashikohet që të ketë rritje të të ardhurave, përfshirë edhe arkëtimin e borxheve të vjetra. Në rritjen e arkëtimin do të ketë ndikim pozitiv në leximin më të saktë të ujëmatësve, me qëllim që konsumatorët të kenë fatura në përputhje me konsumin e tyre mujor. Gjatë këtij procesi, identifikohen dhe eliminohen lidhjet e dyfishta.

Në rast se konstatohet manipulimi me ujëmatës, konsumatorët do të procedohen në gjykatë dhe do të mbajnë përgjegjësi sipas kodit penal.


Në përmirësimin e arkëtimin do të ndikojë edhe fuqizimi i ekipeve të shkyçjes, të cilët do të ndërmarrin veprime konkrete ndaj konsumatorëve për borxhet e papaguara. Po ashtu, forma e pagesave në arkat e Kompanisë do të ketë ndikim në rritjen e arkëtimin. Këto pagesa janë të shpërndara në pjesë të ndryshme të qytetit dhe përfshijnë edhe pagesat e realizuara nëpërmjet llogarive bankare.


Tabela 11 Parashikimi i Arkëtimin

		2023	2024	2025
Shtëpiak	% e arkëtimin	92.00%	94.00%	95.00%
Komercial-industrial	% e arkëtimin	100.00%	100.00%	100.00%
Institucional	% e arkëtimin	100.00%	100.00%	100.00%
Norma e përgjithshme	% e arkëtimin	93.49%	93.50%	96.00%

Tabela 12 Shpenzimet sipas kategorive për vitet 2023, 2024 dhe 2025

Emërtimi i shpenzimit	2023	2024	2025
Ngarkesa për shërbime ndaj ARRU, MMPH, SHUKOS	41,765	41,826	42,777
Shpenzimet e materialit dhe materieve të konsumueshme	134,010	164,085	224,797
Shpenzimet e shërbimeve të kontraktuara	60,682	63,999	64,998
Shpenzimet e energjisë	300,612	287,090	301,822
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	78,636	80,280	81,294
Shpenzimet e derivateve	33,451	51,267	60,808
Shpenzimet e pagave	1,401,244	1,433,267	1,472,923
Shpenzimet tjera direkte dhe indirekte	25,221	44,998	43,005
Total	2,075,621	2,166,812	2,292,424





Grafiku 3 Shpenzimet sipas viteve

Nga grafiku i lartshënuar shohim rritje të shpenzimeve në çdo vit. Kjo na bën të kuptojmë se çdo vit kemi rritje të zonës së shërbimeve dhe marrja e zonave të reja rurale në menaxhim si rrjedhojë e vazhimit të projekteve nga donatorët dhe Komuna e Gjilanit, prandaj rezultojnë me rritje

të shpenzimeve operative e sidomos shpenzimet që ndikojnë drejtpërsëdrejti në koston e prodhimit dhe distribuimit të cilat shumica janë me pompim dhe kanë kosto të lartë edhe për nga mirëmbajtja e tyre dhe në gjitha shpenzimet tjera në tërësi.





9. PLANI I SHËRBIMIT TË SHITJES

9.1 Politikat dhe programet e matjes

Gjatë vitit 2025 planifikohet arritje e caqeve të arkëtimit nga shitja e ujit dhe shërbimeve të tjera duke aplikuar të gjitha masat, si shkycje individuale sipas rasteve dhe shkycje kolektive, sipas nevojës edhe me asistimin e Policisë së Kosovës, gjithnjë duke e respektuar Rregulloren Nr. 06/2016 për Ndërprerjen nga Shërbimet e Ujit në Kosovë. Konsumatorët të cilët largojnë pllombat do të paditen në gjykatë për dëmtim të pllombës/ujëmatësit dhe të njëjtit do të ndëshkohen konform Kodit Penal të Kosovës.

Në vitin 2025 plani ynë do të vazhdojë drejt tërheqjes së konsumatorëve në pikat tona të arkave, me synimin kryesor të menaxhimit më efikas të uljes së shpenzimeve të taksave nga institucionet mikrofinanciare. Gjithashtu, synojmë të jemi më afër konsumatorëve duke ofruar përditësime të rregullta të të dhënave dhe përtëritjen e kontratave të shërbimit, të zhvillojmë aplikacionin online për pagesa, duke krijuar një bazë të rifreskuar për të ndihmuar në menaxhimin e borxheve.

Ky hap do të sjellë një përparim të dukshëm në sektorin e shitjes për të përmirësuar bazën e konsumatorëve.

9.2 Evitimi i lidhjeve ilegale, lidhjeve fiktive dhe lidhjeve pasive

Identifikimi i lidhjeve ilegale do të bëhet në bazë të informatave që i sjellin (sigurojnë) punëtorët-lexuesit tanë nga terreni përmes aplikimit të komperatorëve për identifikimin e lidhjeve të paautorizuara, përmes inspektimeve që do të organizohen në zonat ku humbjet kanë ngritje por edhe me vet lajmërimin nga konsumatorët që deri më tani ishin ilegal.

Për identifikimin e konsumatorëve ilegal në vitin 2025 do të na shërbej shumë sistemi i GIS-it, përmes të cilit do të bëhet identifikimi më i lehtë i konsumatorëve përmes krijimit të aplikacioneve më bazë GIS në software ESRI ArcGIS server Enterprise Standard për lokalizimin e konsumatorëve të kyçur në mënyrë ilegale në rrjet të ujësjellësit si dhe kontroll i lehtë dhe i shpejtë në rast të ri kyçjeve, kjo qasje do të u krijohet lexuesve të zonës dhe ekipit të shkyçjes.

9.3 Përditësimi i bazës së konsumatorëve

Nënkupton identifikimin, incizimin dhe regjistrimin e të gjithë konsumatorëve në të gjithë zonën e shërbimit.

Aktivitetet e planifikuara për arritjen e këtij synimi janë:

- Incizimi i kyçeve shtëpiake dhe ujëmatësve nga ekipet e kompanisë;
- Përditësimi sistematik i të dhënave të incizuara në terren në bazën e të dhënave të konsumatorëve nga njësia e GIS-it;
- Verifikimi i të gjitha rasteve (konsumatorëve) të cilat aktualisht nuk gjenden, nuk faturohen ose janë kyçje të dyfishta. Ndërmarrja planifikon të formojë një komision i cili do të verifikojë të gjitha këto raste të konsumatorëve dhe konform gjetjeve të këtij komisioni do të paraqesë raportin me gjetjet në terren.





10. PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE: 2025-2027

Projekt propozimet e paraqitura në infrastrukturë për periudhën 2025-2027 kanë rëndësi të veçantë për Hidromorava Sh.A., sidomos në uljen e humbjeve të ujit të cilat aktualisht për vitin 2024 janë rreth 52 % nga sasia e ujit të prodhuar. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre humbjeve u takojnë pikërisht humbjeve që vijnë direkt nga rrjeti i amortizuar që në të shumtën e rasteve e kalon moshën 45 vjeçare dhe se i gjithë rrjeti i cili propozohet për ndërrim është nga materiali azbest-cement ose nga zinku.

Investimet kapitale të cilat kanë rrjedhë gjatë përcaktimit të tarifave të ujit janë për këto kategori :

- Përtëritje e infrastrukturës për furnizim me ujë/distribuíim (ndërrim i gypave të vjetër të ujës-jellësit në vlerë prej 146,200.00 €;
- Rritje e infrastrukturës për furnizim me ujë (ndërtim i rrjetit të ri, stacione të pompimeve, rezervuarët) në vlerë prej 45,700.00 €;
- Mirëmbajtje kapitale e jo-infrastrukturës për furnizim me ujë në vlerë prej 76,500.00 €;
- Rritje e jo -infrastrukturës për furnizim me ujë në vlerë prej 60,000.00 €;
- Aktivitete biznesore që nuk lidhen me infrastrukturën ujore në vlerë prej 100,000.00 €;
- Përtëritje në infrastrukturë për ujërat e ndotura në vlerë prej 110,000.00 €;

10.1. Ndërrimi (zëvendësimi) i gypave të ujësjellësit dhe ri kyçjet individuale DN80 mm AC deri DN 200 mm PE (Plan Tarifor)

Tabela 13 Investime në ndërrimin e gypave të ujësjellësit dhe ri-kyçjet individuale

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Ndërrimi (zëvendësimi) i gypave të ujësjellësit dhe ri kyçjet individuale DN80 mm AC deri DN 200 mm PE, Rrugët Mulla Idrizi, Xheladin Kurbaliju, Komandant Drini, Mark Gashi, Shaban dhe Sami Ukshini, Abdullah Presheva (Vëllezërit Frashëri)	200,000.00	Vetanake	2025
Ndërrimi (zëvendësimi) i gypit FI 125 mm, Rruga Beteja e Kikës (ish Kadri Zeka)	15,000.00	Vetanake	2025
Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit, për të kaluar kyçjet individuale të konsumatorëve në Rr. Kemajl Azizi 1800m dhe rreth 60 kyçje individuale	45,700.00	Vetanake	2025
Totali:	260,700.00		

10.2. Investime në kyçjet individuale Komuna Gjilan, Kamenicë

Tabela 14 Investime në kyçjet individuale Komuna Gjilan, Kamenicë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Kyçjet Individuale në zonat Rurale Bresalc, Cërrnicë, Ponesh, Uglar, Komuna e Gjilanit	375,000.00	Komuna e Gjilanit, Qeveria, Donatorët	2025-2027
Ndërtimi i kyçjeve në sistemin e ujit të pijshëm për 2 Fshatra: Hogosht, Karaçevë e Epërme Komuna e Kamenicës	150,000.00	Komuna e Kamenicës, Qeveria, Donatorët	2025-2027
Totali:	525,000.00		

10.3. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Kllokotit

Tabela 15 Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit-Komuna e Kllokotit

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Kllokotit në vendbanimet Kllokot, Mogillë, Vërboc dhe Gërçar.	1,672,394.40	Qeveria, Donatorët	2025-2027
Totali:	1,672,394.40		

10.4. Investime në rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit në zonat rurale Gjilan, Viti

Tabela 16 Investime në rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kyçjet individuale në zonat rurale (Livoç i Epërm, Llashticë, Lladovë) Komuna e Gjilanit	850,000.00	Komuna e Gjilanit, Qeveria, Donatorët	2025-2027
Funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Smirë dhe Vërban - Komuna e Vitisë	230,000.00	Komuna e Vitisë, Qeveria, Donatorët	2025-2027
Totali:	1,080,000.00		

10.5. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit - Zona Urbane Gjilan

Tabela 17. Investime në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kyçjet individuale në zonën urbane Gjilan (Fidanishtja 2)	100,000.00	Komuna e Gjilanit, Qeveria, Donatorët	2025-2027
Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit zona kufitare Gjilan-Novobërdë	620,000.00	Komuna e Gjilanit/Novobërdës, Qeveria, Donatorët	2025-2027
Totali:	720,000.00		

10.6. Ndërtimi i rezervuarit në Gjilan dhe Kamenicë (Proces Tarifor)

Tabela 18. Investime në ndërtimin e rezervuarëve

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Ndërtimi i Rezervuarit V=50 m ³ -Arbëri Gjilan	50,000.00	Vetanake	2025
Ndërtimi i Rezervuarit grumbullues STP Koretin 6m ³	6,000.00	Vetanake	2025
Ndërtimi i Rezervuarit me V=250 m ³ Ne Lokacionin e Stacionit te Pompimit Nr.2 në Kamenicë	80,000.00	Vetanake	2025
Totali:	136,000.00		

10.7. Shtimi i kapacitetit të ujit përmes hulumtimeve të burimeve ujore

Tabela 19 Investime në shtimin e kapaciteteve

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Shtimi i kapacitetit të ujit përmes hulumtimeve të burimeve ujore në Gjilan, Viti dhe Kamenicë ⁴	210,000.00	Komuna e Gjilan, Viti, Kamenicë, Qeveria	2025-2027
Totali:	210,000.00		

10.8. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në zonat rurale Kamenicë dhe Viti

Tabela 20 Investime në ndërtim të rrjetit

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Fshatin Busavatë - Komuna e Kamenicës	315,000.00	Komuna e Kamenicë, Qeveria	2025-2027
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe Kycjet Individuale në Grizime - Komuna e Kamenicës	270,000.00	Komuna e Kamenicë, Qeveria	2025-2027
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kycjet individuale në fshatin Remnik - Komuna e Vitisë	485,000.00	Komuna e Vitisë, Qeveria	2025-2027
Totali:	1,070,000.00		

10.9. Ndërtimi i pusetave për DMA

Tabela 21 Investime në ndërtimin e DMA Zonave

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Ndërtimi i pusetave të ujësjellësit - Krijimi i DMA-zonave Gjilan, Viti dhe Kamenicë	350,000.00	Komuna e Gjilan, Viti, Kamenicë, Donatorët	2025-2027
Totali:	350,000.00		

10.10. Ndërtimi i sistemit SCADA (Moduleve, PLC dhe PC-ve) FPU Përlepnicë

Tabela 22 Investime në ndërtim e sistemit SCADA

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Ndërtimi i sistemit SCADA (Moduleve, PLC dhe PC-ve) FPU Përlepnicë	400,000.00	Qeveria, Donatorët	2025-2027
Totali:	400,000.00		

⁴ Me implementimin e këtij projekti synohet që të arrihet furnizimi i rregullt me ujë të pijes në zonat ku kemi mungesë apo probleme në periudha të caktuara të ujit

10.11. Zëvendësimi i gypit zona urbane Viti

Tabela 23 Investime në zëvendësim të gypave Viti

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Zëvendësimi i gypit DN 80 mm AC me gyp HDPE DN 110mm në qytetin e Vitisë ⁵	130,000.00	Vetanake	2025-2027
Totali:	130,000.00		

10.12. Ndërtimi i kolektorëve fshatrat Përlepnice, Dobërçan, Kmetoc, Shillovë

Tabela 24 Investime në ndërtimin e kolektorëve

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Ndërtimi i kolektorëve fshatrat Përlepnice, Dobërçan, Kmetoc, Shillovë	630,000.00	Komuna e Gjilanit, Donatorët	2025-2027
Totali:	630,000.00		

10.13. Ndërimi i gypit të rrjetit të ujërave fekale (Plan Tarifor)

Tabela 25 Investime në ndërtimin e gypave

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Ndërimi i gypit të rrjetit të ujërave të kanalizimit në rrugën Abdullah Tahiri me gjatësi L=450 m	60,000.00	Vetanake	2025
Totali:	60,000.00		

10.14. Ndërtimi i rrethojës Stacionet e Pompimit Kamenicë

Tabela 26 Investime në ndërtimin e rrethojës

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Rrethoja te Stacioni i Pompimit Nr.1 dhe 2 – Kamenicë	30,000.00	Vetanake	2025
Totali:	30,000.00		

10.15. Investimi në FPU Letnicë

Tabela 27 Investime në ndërtimin e akuatorëve

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Investimi në ndërtimin e akuatorëve (valvulave) FPU Letnicë (9 copë)	72,000.00	Qeveria, Donatorët	2025-2027
Totali:	72,000.00		

⁵ Planifikohet per vitin 2026

10.16. Investimi në Pajisje Elektro-makinerie

Tabela 28 Investime në Pajisje Elektro-makinerie

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Pompa zhytëse dhe centrifugale	60,000.00	Vetanake	2025
Pajisje Elektro-makinerie	20,000.00	Vetanake	2025
Totali:	80,000.00		

10.17. Izolimi i objektit të administratës Viti

Tabela 29 Investime në objekt

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Izolimi i objektit të administratës Viti	5,000.00	Vetanake	2025
Totali:	5,000.00		

10.18. Investimi në renovim të zyrave (të bartura nga 2024)

Tabela 30 Investime në renovime të zyrave dhe arkave

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Ndarje e zyrës - Divizioni Komercial	3,000.00	Vetanake	2025
Kabinete (dollarë metalik për lëndë) për zyre	3,000.00	Vetanake	2025
Renovimi i arkave	5,000.00	Vetanake	2025
Inventar për zyrë Divizioni për Planifikim	1,000.00	Vetanake	2025
Totali:	12,000.00		

10.19. Ujëmatës dhe Pllomba për ujëmatës

Tabela 31. Investime në blerje të ujëmatësve

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Ujëmatës DN 1/2-200 mm ⁶	100,000.00	Vetanake	2025-2027
Pllomba për ujëmatës	5,000.00	Vetanake	2025
Totali:	105,000.00		

⁶ Me këtë investim synohet të zëvendësohen ujëmatësat më të vjetër se 15 vite.

10.20. Blerja e pajisjeve fazonerike

Tabela 32 Investime në blerjen e pajisjeve fazonerike

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Investimi në blerjen e pajisjeve fazonerike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit	50,000.00	Vetanake	2025
Totali:	50,000.00		

10.21. Investimi në rrjetin e kanalizimit te bartura 2024

Tabela 33 Investime në rrjetin e kanalizimit

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Kyçjet (e rrugëve apo shtëpive individuale) përgjatë kolektorit fshati Livoç i Epërm/Livoç i Ulët - Kodra e thatë gjatësi 800m	35,000.00	Vetanake	2024-2025
Totali:	35,000.00		

10.22. Investimi në filtra në Stacione Pompimi

Tabela 34 Investime në filtra të Stacioneve të Pompimit

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Filtra dhe zbutës të ujit për STP Novobërdë, Koretin, Dobërçan, Sadovinë dhe Pozheran. ⁷	100,000.00	Vetanake	2025-2027
Totali:	100,000.00		

10.23. Investimi në FPU (të bartura nga 2024)

Tabela 35 Investime në FPU

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Pompa dozuse të alumin sulfatit dhe pompave për hipoklorit	15,000.00	Vetanake	2025-2027
Dehumudifikatorë (tharëse e ajrit) për FPU Velekincë	26,000.00	Vetanake	2025-2027
Instrumente për matjen e PH klorit dhe turbullirës në FPU Përlepnice	12,000.00	Vetanake	2025-2027
Bombola për klor të gazet (15 copë)	15,000.00	Vetanake	2025-2027
Totali:	68,000.00		

⁷ Në SP në Novobërdë, po thuajse çdo herë që ka të reshura atmosferike në burim depërtojnë ujërat sipërfaqësore dhe si rrjedhojë ngritët turbullira dhe rrezikohet cilësia e ujit. Në SP në Sadovinë dhe Pozheran shpesh kemi ngritje të turbullirës nga burimi i ujit, po ashtu edhe mangan. Në SP në Koretin dhe Dobërçan, ujërat nga këto burime janë me fortësi të lartë dhe është e nevojshme zbutja e ujit

10.24. Investimi në dëmet e shkaktuara nga rrufeja 2024

Tabela 36 Investime në dëmet e shkaktuara nga rrufeja

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Dëmet e shkaktuara nga rrufeja, si pasojë e përqesimit të motit, gjegjësisht goditjeve të rrufesë në afërsi të impiantit në Përlepnice janë dëmtuar disa stabilimente, të cilat kanë ndikuar në ndërprerjen e menjëhershme të prodhimit të ujit.	63,516.00	Vetanake	2025-2027
Totali:	63,516.00		

10.25. Sonda për matjen e parametrave fiziko - kimike

Tabela 37 Investime në Sonda për matjen e parametrave fiziko-kimike

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Sonda për matjen e parametrave fiziko - kimike dhe bakteriologjike për të gjitha pusët në zonën e shërbimit	400,000.00	Qeveria, Donatorët	2025-2027
Totali:	400,000.00		

10.26. Investime në sigurimin e pajisjeve elektrike në FPU Përlepnice dhe Velekincë nga KRU Hidromorava në Gjilan, viti 2024/2025(të bartura nga 2024)

Tabela 38 Investime në sigurimin e pajisjeve elektrike

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Shtëpiza për 7 pusët në Pasjan	56,000.00	Vetanake	2025-2027
Zgjerimi i stacionit të pompimit dhe vendosja e dy pompave centrifugale në Zhegër	60,000.00	Qeveria, Donatorët	2025-2027
Stacioni i ri pompimit në Koretishtë	40,000.00	Qeveria, Donatorët	2025-2027
Modulet të ndryshme të Scadës	15,200.00	Vetanake	2025-2027
Totali:	171,200.00		

10.27. Investime në sigurinë e burimeve të ujit në zonën e shërbimit që menaxhohen nga KRU Hidromorava në Gjilan, Viti dhe Kamenicë viti 2023/2024 (të bartura nga viti 2024)

Tabela 39 Investime në sigurimin e burimeve të ujit - ndërtimi i shtëpizave dhe rrethojave për sigurinë e burimeve ujore

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Njësia Gjilan	126,710.00	Qeveria, Donatorët	2025-2027
Njësia Kamenicë	130,150.00	Qeveria, Donatorët	2025-2027
Njësia Viti	14,545.00	Qeveria, Donatorët	2025-2027
Totali:	271,405.00		

10.28. Investime në blerjen e pajisjeve makinerike

Tabela 40 Investime në blerjen e pajisjeve makinerike

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Furnizimi me një autocisterne me rezervuar 3.5m ³ , për tërheqje dhe debllokim	45,000.00	Vetanake	2025-2027
Cisternë për furnizim me ujë 7-9 m ³ (2 copë)	300,000.00	Donatore	2025-2027
Kamion 5-7 tonësh për adaptimin e cisternës së ujit (2 copë)	30,000.00	Vetanake	2025-2027
Totali:	175,000.00		

10.29. Investimi në pajisje për detektimin e bllokimeve të rrjetit të kanalizimit (të bartura nga 2024)

Tabela 41 Investime në pajisje për detektim të bllokimeve të rrjetit të kanalizimit

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Kamerë dore për kontrollimin e gypave të kanalizimit (30-50m)	4,500.00	Vetanake	2025
Totali:	4,500.00		

10.30. Investimi në siguri dhe punë

Tabela 42 Investime në siguri dhe mjete punë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Pajisje personale mbrojtëse për punëtorët e terrenit (105)	17,500.00	Vetanake	2025-2027
Aparate zjarri (mbushje & servisim) (22 copë)			
Kuti për ndihmë të parë (12 copë)			
Totali:	17,500.00		

10.31. Veturë 4x4 për divizionin për operim dhe mirëmbajtje të rrjetit të ujësjellësit si dhe divizionit për prodhim

Tabela 43 Investime në blerjen e veturave 4x4

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti investimit
Makinë (veturë) për bartjen e punëtorëve për ekipet e ujësjellësit (1) dhe divizionit për prodhim (1) 4x4 (2 copë)	45,000.00	Vetanake	2025-2027
Totali:	45,000.00		

10.32. Pajisje për detektim të humbjeve

Tabela 44 Investime në pajisje për detektim të humbjeve të ujit

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e financimit	Viti investimit
Pajisje për detektim të humbjeve të ujit (defektet që nuk dalin në sipërfaqe)	40,000.00	Vetanake	2025-2027
Totali:	40,000.00		

10.33. Furnizimi me mjete (pajisje) IT (të bartura nga 2024)

Tabela 45 Investime IT

Përshkrimi	Çmimi (€)	Burimet e financimit	Viti investimit
PC workstation (2 copë)	2,500.00	Vetanake	2025-2027
PC (7 copë)	4,000.00	Vetanake	2025-2027
Ploter mbi formatin A3	5,000.00	Vetanake	2025-2027
Kabell UTP EconLine cat 6 Class E, pri+B26zat RJ45, Patch Panel	4,500.00	Vetanake	2025-2027
Swich menaxhueshëm 24 port	1,000.00	Vetanake	2025-2027
Swich menaxhueshëm 48 port	2,000.00	Vetanake	2025-2027
Beckup database cloud	500.00	Vetanake	2025-2027
Wifi UniFi (2 copë)	400.00	Vetanake	2025-2027
Camera sigurise 9 pcs , DVR, cablo, conektor	1,100.00	Vetanake	2025-2027
Microsoft office 365 Exchange 45 user	3,200.00	Vetanake	2025-2027
Mirmbajtja licences se Firwallit Fortinet periudhë 3 vjeçare	2,500.00	Vetanake	2025-2027
Softuer për backup të dhënave	250.00	Vetanake	2025-2027
Camera sigurie , DVR, Cablo, Conektore	1,200.00	Vetanake	2025-2027
Klime ftohëse për dhomën e Serverit ne HO	600.00	Vetanake	2025-2027
Camera sigurie , DVR, Cablo, Conektore	1,600.00	Vetanake	2025-2027
UPS Eaton 9E2000IR, 2000 VA / 1800 W, për RACK kabinete	1,150.00	Vetanake	2025-2027
Server Synology DiskStation DS1821 +	1,600.00	Vetanake	2025-2027
HDD 3.5" 2TB për Synology	660.00	Vetanake	2025-2027
ERP Programi	50,000.00	Vetanake	2025-2027
	370,000.00	Donatore	2025-2027
Paisje per hyrje dalje ANIV2 - W1C Pro	700.00	Vetanake	2025-2027
Projektor me port HDMI	400.00	Vetanake	2025-2027
Camera sigurie , DVR, Cablo, Conektore	12,000.00	Vetanake	2025-2027
Hard Disk SSD 250Gb	175.00	Vetanake	2025-2027
Furnizim me tonera periudha 3 vjeçare	12000	Vetanake	2025-2027
Totali:	479,035.00		

10.34. Projektet e planifikuara të realizohen nga burimet e jashtme për periudhën 2025- 2027.

a) Ndërimi i gypit transportues nga burimi Guri i Hoxhës deri të FPU Përlepnice

Gypi ekzistues i ujësjellësit me gjatësi 3.5 km dhe me diametër DN 300 prej materialit azbest-cement i cili bënë transportimin e ujit nga burimi "Guri i Hoxhës" deri te IPU Përlepnice duhet të ndërrohet për shkak të amortizimit të plotë të tij. Ka mbi 60 vite që është

në operim dhe ka pasur dëmtime të shumta. Traseja aktuale kalon nëpër terren shumë të thyeshëm dhe shumë i vështirë për qasje për mirëmbajtje. Në një pjesë të konsiderueshme të gjatësisë është e nevojshme të devijohet traseja, pra që të instalohet gypi nëpër terren që është me lehtë i qasshëm.



a) Situacioni i propozuar për ndërimin e gypit prej burimit Guri i Hoxhës deri në FPU në Përlepnice

Tabela 46. Situacioni i propozuar për ndërimin e gypit prej burimit Guri i Hoxhës deri në FPU ne Përlepnice

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndërimi i gypit prej burimit Guri i Hoxhës deri te IPU Përlepnice ▪ Hartimi i projektit kryesor ▪ Instalimi i gypit të ri transportues me diametër DN 400, materiali HDPE 100 RC apo DI, gjatësi 3.5 km 	700,000.00	Qeveria e Kosovës, MMPH
Totali:	700,000.00	

Ky projekt është i konfirmuar se do të investohet nga MMPH dhe se ka qenë i planifikuar në buxhetin e Qeverisë së Kosovës për vitin 2022 me numër të kodit: 18977 - "Zëvendësimi i gypit transportues nga burimi Guri i Hoxhës deri te IPU Përlepnicë". Deri në hartimin e këtij Planit të Biznesit nuk kemi konfirmim zyrtar nga MMPH nëse është proceduar për këtë vit.

b) Ndërtimi i Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza si dhe ndërtimi i kolektorëve nga BERZH (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim)

Gjatë vitit 2025 është paraparë fillimi i projektit në dy komponentë të tij:

- ndërtimi e kolektorëve kryesorë, dhe
- ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura në afërsi të fshatit Uglar, përmes investimit të qeverisë së Kosovës përmes kredisë në BERZH dhe EIB dhe grantit nga WBIF.

Sipas planifikimit Impianti për trajtimin e ujërave


te zeza do të vendoset në lokacionin e fshatit Uglar pikë e cila do të mundësojë grumbullimin e gjithë kolektorëve në një pikë përmes gravitetit.

Projekti është në fazën fillestare, shpronësimi i pronave në lokacionin ku do të ndërtohet ITUZ është përfunduar nga Komuna e Gjilanit dhe gjithashtu komuna e Gjilanit është në procedurë për përfundimin e shpronësimit - leje kalimit për trasenë ku do të kalojnë gypat e kanalizimit dhe ka dorëzuar zotimin për përfundimin e kësaj procedure në fillim të vitit 2025 në BERZH.

Procedurat e tenderimit për të gjitha komponentët janë përfunduar përmes rregullave të prokurimit të BERZH dhe në platformën e tyre që quhet ECEPP.

Kontratat që janë në implementim janë ato për PIU konsulencës dhe ajo e FOPIP, kurse për të tre komponentët tjerë janë dorëzuar vlerësimet në BERZH dhe priten miratimet e tyre së shpejti.

Kontratat për ndërtimin e ITUZ, Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimeve dhe shërbimet e inxhinierëve mbikëqyrës pritet të lidhen në fund



të vitit 2024 – fillim të vitit 2025 dhe më pastaj të fillojnë punët në ekzekutim në terren. Projekti pritet të përfundoj në fund të vitit 2026- fillim i vitit 2027.

c) Projekti FLOWS nga Banka Botërore

Projekti FLOWS është një investim nga Banka Botërore që ka dy komponentë, njëri ka të bëjë me zgjerimin e kapaciteteve të ujit në komunën e Kamenicës, përmes studimit të fizibilitetit për ndërtimin e digave në lumin Desivojcë të Komunës së Kamenicës, ndërsa komponenta e dytë ka të bëjë me investimet në KRU Hidromorava në Gjilan sipas kërkesave të Menaxhmentit të KRU Hidromorava të bëra përmes disa takimeve të përbashkëta me përfaqësuesit e Bankës Botërore.

Sipas informatave të marra nga takimet e përbashkëta me përfaqësuesit e Bankës Botërore, vlera e përgjithshme e komponentës II që ka të bëjë me investimet e KRU Hidromorava në Gjilan është 12.4 mil. euro.

Projekti aktualisht është në fazën e përgatitjes vlerësimit të ofertave.



FLOWS



Lista e projekteve të KRU Hidromorava Gjilan për gypat e ujësjellësit- Informatat e përgjithshme

- Ndërrimi i gypit transportues të ujësjellësit L=7,500m', nga FPU- Përlepnice deri në hyrje të qytetit- puseta kryesore afër Qendrës Tregtare "Agmia" Gjilan.
- Ndërtimi i gypit të ri nga rreth rrotullimi përballë fabrikës së IBG- Gjilan L=6,500m', përgjatë rrugës qarkore deri të puseta kryesore e gypit të çelikut.
- Ripërtëritje e rrjetit ekzistues ujësjellës L=3,000m': nga puseta kryesore te Qendra Tregtare Agmia deri tek udhëkryqi i rrugës te kompleksi banesor "FITORIA".
- Ripërtëritje e rrjetit ekzistues ujësjellës L=7,000m': Lagja ILIRIA në Kamenicë.
- Krijimi i DMA zonave për menaxhim të humbjeve të ujit: Gjilan, Viti dhe Kamenicë.
- Rritja e efikasitetit të energjisë - rivitalizimi i stacionit të pompave.
- Ndërtimi i rezervuarit të ri me vëllim V= 3500m3 FPU Përlepnice.
- Shtimi i kapaciteteve të ujit në FPU Letnicë Viti.



11. REKAPITULLIMI I PROJEKTEVE 2025-2027 NGA INVESTIMET E KRU HIDROMORAVA/ DONATORË

Tabela 47 Rekapitullimi i investimeve vetanake 2025

Investimet me mjete vetanake 2025	
Investimet infrastrukturë	638,700.00
Investimet Makineri-Mjete pune	4,500.00
Totali:	643,200.00

Tabela 48 Rekapitullimi i investimeve vetanake 2025-2027

Investimet me mjete vetanake 2025-2027	
Investimet infrastrukturë	526,716.00
Investimet Makineri-mjete pune	177,500.00
Investime IT	109,035.00
Totali:	813,251.00

Tabela 49 Rekapitullimi i investimeve nga donatorët 2025-2027

Investimet me donatorë 2025-2027	
Investimet donatorë infrastrukturë	7,506,799.40
Investimet donatorë Makineri-mjete pune	300,000.00
Investime donatorë IT	370,000.00
Totali:	8,176,799.40

Tabela 50 Rekapitullimi i investimeve sipas kategorive 2025-2027

Rekapitullimi i investimeve 2025-2027	
Vlera totale e Investimeve në infrastrukturë	8,672,215.40
Vlera totale e investimeve në makineri dhe mjete pune	482,000.00
Vlera totale e investimeve në IT	479,035.00
Totali:	9,633,250.40



Gashi

Më: 31.10.2024

Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve

znj. Fillorete Gashi Sadiku

NA KONTAKTONI:

-  Rr. Vëllezrit Gërvalla, Nr. 71
Gjilan, Kosovë
-  info@hidromorava.com
-  0800 61 000